



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISE

Datë 26.05.2023

Prot.74 (shtatëdhjetëkatër)

Protokoll nr. 74

I mbajtur sot më datë 26.05.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.04.2023;
3. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2023”;
4. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë Maliq për muajin prill 2023”;
5. P-V “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”;
6. P-V “Për bashkëfinancim emergjent të projektit në fushën e arsimit”;
7. P-V “Për detajimin e fondevë (transferta specifike) për rritjen e pagave për vitin 2023 të funksioneve specifike në Arsim, MZSH, Ujitje Kullim, Pyje”;
8. P-V “Për miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2023”;
9. P-V “Për rishikim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.106, datë 19.12.2022 “Miratimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023” pika C/b gërmë (t);
10. P-V “Për pagesën e nxënësve fitues që zunë vendin e pare në rang qarku”;
11. P-V “Për miratimin e Raportit të konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2022”;
12. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Idlir Limllari; Aleksandër Petriti; Pranvera Begolli; Floreta Zaçe; File Qyrani; Erinda Xhaferllari; Armando Dautllari; Dritan Çami; Almir Elezi; Fevri Sherifi; Ilia Xhuti; Kristina Malelli; 13 (trembëdhjetë) këshilltarë

Këshilltarë online në platomën ZOOM:

Enida Avdolli; Esmeralda Spaho; Gentina Drabo; Kristina Jonusllari; Rexhina Hëna; Jonilda Koçllari 6 (gjashtë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Zv/Kryetari i Bashkisë znj Jonila Xhihalli; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj. Ermando Petriti; Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj. Almira Muka; Përgjegjës pranë Drejtorisë së të Ardhurave znj. Alma Shkëlqimi;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve, saleminderit kemi thirur këtë mbledhje emergjente të Këshillit të Bashkisë Maliq, emergjente sepse dhe ligji e parashikon, neni 53 “Funksionimi Këshillit të Bashkisë”, i ligjit 139/2015, pika 6, Këshilli mblidhet për kushte emergjente, kishim disa P-V që duhet të miratoheshin para se të konstituohet Këshilli i ri, si Ndihma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ekonomike apo dhe një investim i shumë pritur rikëinstruksioni i shkollës së Pojanit i cili zgjidh mësimin me turne dhe në këto kushte vendosëm, duke patur dhe hapsirë ligjore të thërasim një mbledhje emergjente.Ju jeni njohur me rendin e ditës dhe materialet, mbledhjen nga ekzekutivi po e shoqëron, Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhithalli, kemi dhe Drejtoren e Financës dhe Buxhetit;zpj.Almira Muka, kështu mund të vazhdojmë.Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online .Ju konfirmoj dhe kurumi realizohet, kemi 13 Këshilltarë në sallë dhe 6 onilne, vazhdojmë me rendin e ditës. Më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kalur.

1-Vendim nr.49, datë 28.04.2023

“Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të Bashkisë Maliq”;

Shënim:Ju vemë në djeni se në mbledhjen e datës 28.04.2023 të këshillit të Bashkisë Maliq u miratuan dhe 7 (shtatë) vendime me karakter kolektiv ose individual, përkatësisht:

1-Vendim nr.43, datë 28.04.2023

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 28.04.2023”;

2-Vendim nr.44, datë 28.04.2023

“Për miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.03.2022”;

3-Vendim nr.45,datë 28.04.2023

“Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2023”;

4-Vendim nr.46, datë 28.04.2023

“Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë Maliq për muajin mars 2023”;

5-Vendim nr.47, datë 28.04.2023

“Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;

6-Vendim nr.48, datë 28.04.2023

“Për miratimin e listës së përsituesve nga programi subvencion i intresave të kredisë për strehim”;

7-Vendim nr.50, datë 28.04.2023

“Për shpenzime varrimi Subjektit “Nertila Ahmetaj”

Ornildi Demollari: Miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit!Miratohet me 19 vota pro. Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2023”; Ka ndonjë pyetje ose koment? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit!Miratohet me 19 vota pro. Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë Maliq për muajin prill 2023”; Ka ndonjë pyetje ose koment? E kalojmë në votim?



Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet me 19 vota pro. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile";

Pranvera Begolli: Përshëndetje! Doja të dija cilat objektet infrastrukturore që do reabilitohen?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj. Almira Muka: Përshëndetje! Nga mborjtja civile ky është fond i kushtëzuar që vjen nga Ministria e Mbrojtjes, çelja është bërë në vlerën 8.218.788 lekë, sipas vendimit të K.M dhe udhëzimit të Agjencisë të Mbrojtjes Civile ky fond duhet të shpërndahet, merret një vendim ku duhet të përdoret, sipas parashikimeve, sipas parashikimeve të vitit të kaluar, ky është një plan jo fakt, 13 milion i kemi lenë për rënien zjarri, vitin e kalur ishte 3.2 milion lekë u realizua 1.9 milion aq sa pati raste zjarri dhe përmbytje baneshash. Pjesa tjetër është VKM për blerje mjeti, kemi vendosur të blemë një Vinç për lartësinë që do përdoret nga Emergjencat, pas specifikimeve teknike nga Mekanika, vlera u vendos 2 milion lekë, pjesa tjetër është për rabilitimin e pallateve, si çati, pallatet dojenë në të gjitha NJ.A, kjo është ndarja e fondit sipas rasteve emergjente.

Ornildi Demollari: Kjo është vetëm për pallatet apo dhe banesa individuale?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj. Almira Muka: Do ndërhyhet te ato pallate dhe banesa ku është emergjente që janë dëmtuar nga zjarri ose nga kushte të tjera atmosferike. Kjo ndarje është në parim. E kemi detyrim ligjor ta specifikojmë zëra.

Ornildi Demollari: Në vartësi të nevojave, dakord! Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet pika 5 me 19 vota pro. Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për bashkëfinancim emergjent të projektit në fushën e arsimit";

Ornildi Demollari: Bëhet fjalë për rikonstruktionin e shkollës të Pojanit, është diçka për tu përshëndetur sepse ka qenë një kërkesë e banorve të Pojanit por dhe e Arsimtarve për shkak të mësmit me turne. Ka ndonjë pyetje? Jemi falenderues për qeverinë Shqipëtare, MASH dhe Bashkisë për insitim të realizohesha ky investim. Ka ndonjë pyetje?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj. Almira Muka: Fondi total për shkollën e mesme të Pojanit është 64 milion 117 mijë lekë, ne duhet të bëjmë bashkë financeim 20% të vlerës, që shtë 12 milion e 823 mijë lekë, ky fond erdhi jashtë buxheti të miratuar, ndaj kemi bërë dhe këtë ndryshim duke pakësuar disa zëra.

Ornildi Demollari: E qartë, Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet pika 6 me 19 vota pro. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për detajimin e fondeve (transferta specifike) për rritjen e pagave për vitin 2023 të funksioneve specifike në Arsim, MZSH, Ujitje Kullim, Pyje": Ka ndonjë koment? Drejtoresh na bëj një shpjegim?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj. Almira Muka: Ky është fond i kushtëzuar nga transferta specifike, rritja e pagave për arsimin e mesëm dhe arsimin parashkollar dhe për MZSH, Ujitje Kullim dhe Pyje, që nga muaji Prill është bërë rritja e pagave atëherë Ministrat



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

e Financave dhe Ekonomisë ka bërë çelje fondi për këtë shtesë, çelja e fondit bëhet gjithmonë me në grupin transfera dhe ne kemi bërë specifikimet ku do përdoret ky fond, për paga dhe sigurime dhe kemi bërë ndryshim, pakësohet gruji 604 dhe shtohet për paga dhe sigurime është fond i kushtëzuar nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë përritjen e pagave.

Ornildi Demollari: E qartë, Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet pika 7 e rendit të ditës me 19 vota pro. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për miratiimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2023";

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje për Raportin e parë të Monitorimit?

Pranvera Begolli: Shoh një pikë ku thotë që të tarifat jo-tatimore për 8-mujorin janë realizuar në masën 30%, dua të di arsyen? Tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërmit, mirëmbajtjes, këto nuk janë arkëtuar nga qytetarët?

Përgjegjës pranë Drejtorisë së të Ardhurave znj. Alma Shkëlqimi: Përvendetje! Në lidhje me problemin që ngriti Vera, të ardhurat jatatimore janë realizuar në masën 30%, por këtu përfshihen disa të ardhura që fillojnë të vilen në periudhën e mëvonëshme, sepse janë të ardhura nga drutë e zjarrit, nga fushata e korjeve dhe kazanët e Rakisë. Po të shohim tarifën e pastrimit është realizuar në masën 40%, 30% është në total, ndrièimi 38%.

Pranvera Begolli: Dua di arsyen pse? duke qenë këto tarifa kanë qenë gjithmonë në tritje 40-38%. Kaq doja faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Alma! Ka ndonjë gjë tjetër Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet pika 8 e rendit të ditës me 19 vota pro. Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, P-V "Për rishikim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.106. datë 19.12.2022 "Miratimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023" pika C/b gëрма (t); Bëhet fjalë përshtesë limit karburantit.

Pranvera Begolli: Pse shtohet dhe cili është mjeti?

Ornildi Demollari: Për arsyet e ngarkesës së punës, është e nevojshme një shtesë prej 100 litra në muaj limiti karburanti përmjetin e Agjencisë së Rrugve me traga AA371PG.

Drejtore e Financës dhe Buxhetit;zpj. Almira Muka: Mjeti është i Agjencisë së Rrugve Rurale, Kamioni i Rrugve Rurale e ka patur normën në buxhet 400 L, por duke parë që gjatë që kjo sassi nuk është mjafshëm përmjet shkak të volumit të punës dhe konsumit të mjetit. Kamioni përdoret dhe për punë të tjera, prandaj u pa e arsyeshme të shtoheshme limiti nga 400 litra në 500 litra.

Ornildi Demollari: Shtesa duket e arsyeshme përmjet shkak të volumit të punës, ka ndonjë paqartësi tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet pika 9 e rendit të ditës me 19 vota pro. Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës, P-V "Për pagesën e nxënësve fitues që zunë vendin e pare në rang qarku";



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Ornildi Demollari:Drejtoresh mund tē na shpjegoni diçka se nuk ka material pēr këtë?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit;zpj.Almira Muka:Si vendim ju e kemi miratuar mbledhjen e kaluar nē parim.

Ornildi Demollari:Janë ata tre studentët?

Drejtore e Financës dhe Buxhetit;zpj.Almira Muka:po pēr ata bëhet sjalë, nē parim është miratuar, tani u pa e arsyeshme tē shihet dhe pēr një mbështetje financiare pēr secilin.

Pranvera Begolli:Thjesht do miratojmë vlerën? Nē parim ne e kemi miratuar. Tē ketë P-V tē miratojmë vlerën.

Drejtore e Financës dhe Buxhetit;zpj.Almira Muka:Vlera shkon nga 1115 Euro pēr çdo student.Vlera totale është 3375 Euro.

Ornildi Demollari:Kalojmë te pika tjetër sa tē qartësohem i pēr këtë, kalojmë te pika 11 e rendit tē ditës, P-V “Pēr miratimin e Raportit tē konsoliduar pēr veprimitarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit tē Bashkisë Maliq pēr vitin 2022”;

Drejtore e Financës dhe Buxhetit;zpj.Almira Muka: Raportit i konsoliduar pēr veprimitarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit tē Bashkisë Maliq pēr vitin 2022, sipas ligjit 68/2017 “Per financa e vetëqeverisjes vendore” neni 51, pika 1, Kryetari i Njësisë së qeverisjes vendore, së bashku me drejorinë e finances dhe buxhetit, paraqitin nē këshill brenda dates 31 maj Raportit i konsoliduar.Ky Raport përfshin, Raportin e Monitorimit vjetor, ku janë shpenzimet dhe tē ardhurat, përfshin pasqyrat financiare ose bilanci vjetor dhe pasqyrat financiare, janë dy paqyrat më tē rëndësishme, që është pozicioni financiare, ku janë pasqyrat aktive dhe pasive dhe performance financiare që janë tē ardhurat dhe shpenzimet.në raport janë pasqyraur tē gjitha, si bilanci është nga data 1 janar deri 31 dhjetor 2022, është dorzuar nē degën e Thesarit Brenda asfatit tē përektuar dhe janë marrë dhe vulat përaktëse me shkresat.Në këtë raport krahës bilancit, po tē ketë ndonjë pyetje? Mund ti shpjegoj, mjetet active dhe detyrimi janë pasqyruar qartë nē raport.Gjitashtu pasqyra tjetër është, performance financiare, tē ardhurat dhe shpenzimet, po ashtu nē këtë raport është bërë dhe analiza që drejoria e tē ardhurave dhe drejtoria e finances. me tē gjitha punët që janë bërë gjatë vitit.Këtu pjësë është dhe raportit tē Auditit tē Brendshëm si detyrim ligjor.Nëse ka pyetje?

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër pēr Raportin pēr pasqyrat financiare, tē ardhurat, shpenzimet?

Pranvera Begolli:Nuk kemi, e kalojmë nē miratim.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje tjetër?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët nē sallë dhe 6 online.

Faleminderit!Miratohet pika 11 e rendit tē ditës me 19 vota pro.

Ornildi Demollari:Kërkoi mirëkuptimin tuaj pēr tē miratuar dhe dy P-V tē tjera tē cilat i kemi, ne i kemi trajtuar nē mbledhjen e kaluar, por pēr shkak kanë bëjnë me ndryshime nē administratë dhe nē periudhë zgjedhore na ndalohej tē merrnim vendime tē tillë, çdo institucion e kishte tē ndaluar tē bënte emëri me nē periudhë fushatë.Na i kanë sjellë sot, këto P-V nuk janë tē panjohura pēr ne, tu ju lutesha ti kalonim nē votim.P-V i parë është, P-V “Pēr disa shtesa dhe ndryshime nē Vendimin e Këshillit tē Bashkisë me nr.105 datë 19.12.2022 “Pēr miratimin e numrit tē punonjësve, nivelin e pagave tē Administratës tē Bashkisë dhe strukturave tē tjera” i ndryshuar. Tē bëjë ndryshime nē pozacione pune si më poshtë:

Në strukturën e Bashkisë Maliq (qëndër), Lidhja nr.1 tē bëhen disa shtesa dhe ndryshime nē pozicionet e punës si më poshtë:



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

Në "Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit" në "Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve", të bëhet ndryshimi i pagës të pozicionit të punës "**Specialist /Inxhinier**" në kategorinë IV-a, me pagë grapi nga 10.000-14.000, ndryshimi për pagën për funksion në masën **25.000** (*njëzetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 2% për vjetërsi në punë.

Në struktura e Sektori Mekanik, Lidhja nr. 4 të bëhet ndryshimi në pozicionin e punës si më poshtë:

Në emërtesën e pozicionit të punës "**Nëpunës Transporti-Ekonomiste**" me profil (*Ekonomist – Financë*), në kategorinë në III-b, me pagë grapi nga 10.000-14.000, të bëhet ndryshimi për pagën për funksion në masën **42.000** (*dyzet e dy mijë*) lekë dhe shtesë 2% për vjetërsi në punë.

Në struktura e "Sektori i Shërbimit Publik", sektori i sherbimit "Shërbimeve -Bashkia Qëndër" Lidhja nr. 5 të bëhet shtesa dhe ndryshime në pozicionet e punës si më poshtë:

Për pozicionin e punës "**Punonjës Administrativ**" pika 19 e VKM-së 165/2016, (*Punëtor pastrimi -Lulishtare*), të bëhet ndryshimi i orëve të punës në 8 orë punë në ditë në masën **40.000** (*dyzetë mijë*) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%.

Për pozicionin e punës "**Punonjës Administrativ**" pika 19 e VKM-së 165/2016, (*Punëtor Pastrimi -Shkolla Libonik*), të bëhet ndryshimi i orëve të punës në 8 orë punë në ditë në masën **40.000** (*dyzetë mijë*) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%.

Për pozicionin e punës "**Punonjës Administrativ**" pika 19 e VKM-së 165/2016, (*Punëtor Pastrimi -Shkolla Libonik*), të bëhet ndryshimi i orëve të punës në 8 orë punë në ditë në masën **40.000** (*dyzetë mijë*) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%.

Për pozicionin e punës "**Punonjës Administrativ**" pika 19 e VKM-së 165/2016, (*Punëtor +Roje Fushe*), të bëhet ndryshimi i orëve të punës në 8 orë punë në ditë në masën **40.000** (*dyzetë mijë*) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%.

Në struktura e Sektorit "Pyje dhe Kullota", Lidhja nr. 6 të bëhet shtesa dhe ndryshime në pozicionet e punës si më poshtë:

Në sektori "Pyje Kullota", në "Sektori i Menaxhimit", të hiqet pozicioni i punës "**Teknik pyjesh**" (pika 6).

Në sektori i "Pyje dhe Kullota", në sektori i "Pylli i Fazanëve" të shtohet pozicioni i punës "**Inxhinier Pyjesh**" me kod (2133.13), me kategori IV-a, me pagë për funksion **30.000** (*tridhjetë mijë*) lekë dhe shtesën për vjetërsi në masën 2% .

Në struktura e Sektorit "Sektori i Rrugëve Rurale 2023", Lidhja nr. 7 të bëhet ndryshimi në pozicionet e punës si më poshtë:

Për pozicionin e punës "**Punonjës Administrativ**" pika 19 e VKM-së 165/2016, (*Punëtor krahu mirëmbajtje - Maliq*), të bëhet ndryshimi i orëve të punës në 8 orë punë në ditë në masën **40.000** (*dyzetë mijë*) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%. Ky është P-V që ne e kemi trajtuar më parë, ka ndonjë pyetje?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit! Miratohet me 19 vota pro.

Ornildi Demollari:Dhe P-V tjetër është, P-V "Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirje sociale për të moshuarit":Bëhet fjalë për të shtuar një punonjës sallë, për të cilin nuk mund të bëheshe shtesa gjatë periudhës të fushatës, me page



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

minimale+sigurime shoqërore dhe 6 orë punë, bëhet fjalë për të shtuar një punonjës te Qendra e të Moshuarve NJA Libonik, janë fonde që akordohen nga Këshilli i Qarkut. E kemi miratuar dhe më pare. Ka ndonjë pyetje?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 6 online.

Faleminderit!Miratohet me 19 vota pro.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Kthehem i pika 10.

Pranvera Begolli:Të plotësohet me P-V dhe vlerë dhe e kemi të kaluar, Miratohet me 19 vota pro.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Jemi te diskutime të tjera, kemi diçka tjetër? Nuk kemi, këto ishin pika e mbledhjes, për të cilin do plotësohet me dokumentacioni.

Faliminderit!

Mbledhja mbyllt!

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

